



Datë: 18.12.2025
Numër Protokolli: 8130/2025

A.nr.1416/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1416/2025, të datës 21.07.2025, të parashtruar nga ankuesja Sh.V, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1416/2025, e datës 05.05.2025, e parashtruar nga ankuesja Sh.V.

II. Anulohet masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim” e shqiptuar ndaj ankuses nga Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes aktit me Ref:278/2025, të datës 23.06.2025, ndërsa, **çështja kthehet në rishqyrtim të organi i njëjtë/Sekretari i Përgjithshëm**, me detyrimin që ky i fundit në ri procedurë të merr parasysh pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësja cilëve Sh.V (*tutje referuar ankuesi*), me datë 21.07.2025, fizikisht ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje me Shkrim”, e shqiptuar përmes aktit Nr. Ref:278/2025, të datës 23.06.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve ligjore dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), ndërsa, kjo e fundit me datë 01.08.2025, ka përcjell shkresat e bashkëngjitura të lëndës, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4857/2025 të datës 21.07.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Masa disiplinore Vërejte me Shkrim me Nr. Ref:278/2025, të datës 23.06.2025; Emailin e datës 02.07.2025 nga ankuesja për I.M; Kërkesën për fillimin e procedurave të rekrutimit të datës 12.05.2025; Vendimin për pushim vjetor datës 27.05.2025; Emailin e datës 24.12.2024 nga R.S për Burimeve Njerëzore MPJD; Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen datë 31.01.2023, 22.02.2024; Vendimin me Nr. 11/2022 të datës 10.05.2022 për transferimin e ankueses; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 23.11.2011; Kopjen e ID-së së ankuese; Kërkesën për përgjigje nën ankesë e datës 29.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 01.08.2025; Përshkrimin e pinës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime; Vërejtjen me Nr. Ref: 12/2023 të datës 23.01.2023; Vendimin me Nr. Ref 25/2024 të datës 30.01.2024 për transferim të përhershëm të ankueses; Vendimin me numër protokolli 336 të datës 22.01.2024 të Komisionit Disiplinor të MPJD-së; Akt Emërimit me Nr.878/2024 të datës 01.08.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimi dhe analizimit të prove materiale të administruara ka gjetur se ankesa **është e bazuar, sepse:**

Gjendja e Çështjes

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë:

- Ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.878/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime në MPJD.

-Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së përmes aktit më Nr. Ref:278/2025, të datës 23.06.2025, ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “Vërejtje me Shkrim”, me arsyetimin se: *Pasi që si Sekretari i Përgjithshëm, disa herë ju kam drejtuar Departamentit për Shërbime të Përgjithshme/Divizionit për Logjistike dhe Shërbime, për mungese e caktimit të një zyrtarit në recepsion. Më konkretisht herën e fundit më datë 17.06.2025, përmes emailit ju kam drejtuar divizionit/departamentit përkatës për mungesën e angazhimit të një personi në recepsion, ku decidivisht kam shkruar se që të jem është me i qartë, ky është paralajmërimi i fundit nga ana ime si SP për çështjen e mungesës së zyrtarëve në recepsion.*

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e masës disiplinore “Vërejtje me Shkrim “ të datës 23.06.2025, më pretendimet së kjo masë disiplinore është bazuar në emailin e datës 17.06.2025, kur në këtë kohë kam qenë në pushim vjetor, dhe kjo është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.01.2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civilë. Shton së disa herë janë ndërmarr veprimet duke parashtruar kërkesë që pozitë në recepsion të mbulohet, mirëpo nuk janë ndërmarr veprime. Kërkon që ankesa të aprovohet, të shfuqizohet masa disiplinore e kontestuar dhe të obligohet institucioni që masën disiplinore ta largoj nga dosja personale e saj.

Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve të ankueses, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, me theks të veçantë:

-Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

-Nenit 56, paragrafi 1 dhe 3: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun.*

-Nenit 57: 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; **1.3. vërejtje me shkrim.**

Nenit 58, paragrafit 1 dhe 2: **1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ.** 2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor.

Referuar kuadrit ligjor si me sipër Kolegji ka analizuar aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton së masa disiplinore “vërejtje me shkrim” e shqiptuar ndaj ankues më datë 23.06.2025, nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, nuk bazohet në vërtetim të plotë dhe të plotë të gjendjes faktike, mbi arsyen, se në përgjigjen në ankesa organi i punësimit nuk ka ofruar asnjë dëshmi që vërteton faktin e potencuar në aktin e kontestuar së Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së disa herë i është drejtuar më kërkesë Divizionit të Logjistikës dhe Shërbimit për mungese të një zyrtari në recepcion dhe atë herën e fundit më datë 17.06.2025. Për më tepër, ankuesja bazuar në vendimin për pushim të datës 27.05.2025, i është aprovuar pushimi vjetor për periudhë 10.06.2025 deri më datë 19.06.2025, kështu që, për këtë periudhë ankuesja nuk mund të vihet nën përgjegjësi disiplinore, Po ashtu, në gjykim të Kolegjit ka kundërthënë në mes të aktit të kundërshtuar dhe përgjigjes së ankesë, sa i për kohës që i referohet masa disiplinore, pasi që, në përgjigje në ankesë është thënë së masa disiplinore “vërejtje me shkrim” është dhënë si pasojë e asaj së me datën e shqiptimit të kësaj mase ka munguar një zyrtar në recepcion, ndërsa, akti i kontestuar i referohet një periudhe tjetër paraprake duke aluduar në kërkesën e fundit me datë 17.06.2025. Andaj, mungesa e këtyre e fakteve-dëshmime dhe kundërthënieve si më sipër, ka pamundësuar vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, kështu që, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 1.2. dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht aprovoj ankesën, anuloi aktin e kontestuar dhe çështjen e kthej në rishqyrtim të organi njëjtë, më detyrimin që ky i fundit të ri procedurë të merr parasysh pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.1416/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses Sh.V;
- MPJD-së: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.